



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 101/ Prot.
13

Tiranë, më 19 / 01 / 2022

VENDIM
Nr. 3, datë 19.01.2022

“PËR NISJEN E PROCEDURAVE PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË DHE MIRATIMIN E KRITEREVE QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT QË DO TË APLIKOJNË PËR TË QENË ANËTAR NË KËTË KOMISION”

Në bazë të neneve 3, 37, 38, 46 e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 5, 25, 26, 32, 33 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në Vendimin e Senatit Akademik të UMT-së nr.15, datë 17.02.2020 “Për krijimin e komisionit të përhershëm ...” dhe sipas propozimit përkatës, Senati Akademik, pasi diskutoi mbi mbarimin e mandatit 2-vjeçar dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtarë të Komisionit të Përhershëm të Promovimit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që do të aplikojnë për të qenë anëtarë të Komisionit të Përhershëm të Promovimit Akademik (KPPPA) në UMT, si më poshtë:
 - a) Të jetë personel akademik me kohë të plotë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;
 - b) Të mbajë titullin akademik “Profesor”;
 - c) Të mos jetë në ndjekje penale dhe ndaj tyre të mos jetë dhënë masë e sigurimit personal;
 - d) Të mos jetë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - e) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - f) Të mos ketë shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike” i ndryshuar dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
 - g) Të mos jenë anëtar në më shumë se 2 (dy) komisione të përhershme;
 - h) Të mos jenë anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Dhënie e gradës shkencore “Doktor” në njësitë kryesore të Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

2. Përzgjedhja e anëtarëve të Komisionit të Përhershëm të Promovimit të Personelit Akademik në UMT do të kryhen nëpërmjet procesit të votimit të fshehta nga anëtarët e Senatit Akademik të UMT-së, pas mbylljes së afatit të aplikimeve dhe verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidatëve aplikues.
3. Procedurat e aplikimit, afati dhe dokumentacioni që do të depozitohen kandidatë për të qenë anëtar të KPPPA-së do të përcaktohen me Urdhër të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe në kriteret e pikës 1 (një) të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, ju njoftohet njësisë kryesore të UMT-së dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

KRYETARI
ARBEN GJATA

A circular official stamp of the University of Medicine and Pharmacy 'Nënë Tereza' in Tirana. The stamp contains the text 'UNIVERSITETI I MJEKËSISË - NËNË TEREZA' and 'TIRANË'. A handwritten signature in black ink is written over the stamp.